

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, në trupin gjykues të përbërë nga kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Vesel Ismaili, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Nurije Rexhëbeqaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit nga i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – DKR, PP/I.nr.153/2016 të dt.22.03.2016, për shkak të veprës penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi ,prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 372 par.1 të KPRK-së, pas zhvillimit të shqyrtimit fillestarë publik e verbal me dt.26.12.2017, në prezencën e prokurorit të shtetit Hivzi Bajraktari dhe të akuzuarit, mori dhe publikisht shpalli këtë:

### AKT GJYKIM

I akuzuari:

,nga i ati dhe nëna e gjinisë i lindur më dt. në fsh. Komuna e tani me vendbanim në në rr. nr. , i martuar , baba i fëmijëve, me vendbanim dhe punë të përkohëshme në me nr.personal , më parë i pa gjykuar, kundër tij nuk zhvillohet procedure për veprë tjetër penale , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me shkeljen e ligjit të zbatueshëm në lidhje me armët apo mjetet plasëse, nga shtetet e jashtme ka importuar armën , pushkë të gjatë me një tytë , e tipit “Hysforna”M-48 , e prodhimit Suedez , me numër serik 374274, me dylbi të prodhimit Amerikan të vendosur në armë , në atë mënyrë që me datën 11.03.2016 rreth orës 22:00 me rastin e kalimit të pikës kufitare nga Serbia në Republikën e Kosovës , nga Policia Kufitare e Kosovës në Merdare , është ndaluar automjeti i tipit “Peugot Eksport ”me targa të regjistrimit të me numër , të cilën e drejtonte i pandehuri , dhe me rastin e kontrollimit të automjetit , në pjesën e pasme të ulëses së drejtuesit të automjetit , është gjetur arma e lartëcekur ,të cilën i pandehuri e kishte qmontuar dhe e kishte mbështjellë me gjësende për të mos e vërejtur , me q rast policia të njëjtën e sekuestron.

Me këtë ka kryer veprën penale Importi,eksporti,furnizimi,transportimi,prodhimi,këmbimi,ndërmjetësi mi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 372 par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 3, 4, 49, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76 dhe 372 par.1 të KPRK-së, dhe në bazë të neneve 359, 361, 365 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton

### DËNIM TË KUSHTËZUAR DHE DËNIM GJOBE

Dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilin dënim nuk do ta vuaj në qoftë se në periudhën kohore prej 2 (dy) viteve nuk kryen vepra tjera penale.

Dënim gjobe në lartësi prej 800 (tetëqind) euro, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat ligjor prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën e shqiptuar brenda afatit të paraparë ligjorë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgu duke ju llogaritur për një ditë burgim nga 20 (njëzet) euro.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale ta paguaj shumën aq sa do të bëhet sipas fletë shpenzimore së kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) € në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **DËNIMI PLOTËSUES**

Konform nenit 62 lidhur me nenin 69 par.1 të KPRK-së, të akuzuarit i konfiskohet pushka e tipit "Hysforna" M-48 e prodhimit Suedez , me numër serik 374274, si mjet me të cilin është kryer vepra penale.

### **ARSYETIM**

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, me Aktakuzën PP.I.nr.153/2016 të dt.22.03.2016 , e ka akuzuar të pandehurin \_\_\_\_\_ për veprën penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 372 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata zhvilloi shqyrtimin gjyqësor fillestarë publik e verbal më dt. 26.12.2017, dhe pas leximit të dispozitivit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i akuzuari deklaroi se në tërsi e ka kuptuar aktakuzën, veprën penale për të cilën akuzohet dhe në tërsi e pranoi fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale, e në vazhdim thekson se pendohej thellë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, i premtoj gjykatës që kurrë më në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla apo çfarëdo qofshin ato, andaj e lus gjykatën që të më shqipton një dënim sa më të butë të mundshëm i cili dënim do ta ketë efektin pozitiv tek unë që në të ardhmen mos të përsëris vepra të tilla.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin fajësinë nga ana e të akuzuarit për veprën penale për të cilën akuzohet deklaroi: se pajtohem në tërësi me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që pranimi i fajësisë është bërë konform dispozitivave ligjore nga neni 248 të KPPK-së, ai ka kuptuar benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se një pranim i tillë është në përputhshmëri me provat që gjenden në shkresat e lëndës, i propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit për veprën penale që i vihet në barrë , me rastin e matjes së dënimit të ketë parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë në këtë fazë të procedurës.

Gjykata pas shqyrtimit, vlerësimit dhe analizimit të mbrojtjes së të akuzuarit, i cili në tërësi e pranoi fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, shqyrtimin dhe analizimin e të gjitha shkresave të lëndës, dhe të gjitha provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, vërtetoi në masë të mjaftuar se te i akuzuari sajohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 372 par.1 të KPRK-së ,andaj të akuzuarin e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së dënimit llojit dhe lartësisë së tij gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 73 të KPRK-së, e të cilat janë me ndikim me rastin e individualizimit të dënimit, e si rrethanë rënduese mori parasysh peshën e rëndë të veprës penale, kurse si rrethana lehtësuese morri parasysh pendimin e tij të thellë për veprën e kryer penale, se më parë nuk ka qenë i gjykuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla apo çfarëdo qofshin ato, e si rrethanë veçanërisht lehtësuese mori parasysh pranimin



e fajësisë për kryerjen e veprës penale, andaj të akuzuarit i shqiptoi dënim alternativ – dënim me kusht dhe dënim me gjobë, me bindje se ky dënim i përgjigjet rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë të shqiptuar gjykata mendon se do të arrihet efekti dhe qëllimi i shqiptimit të dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi obligimin e të akuzuarit për pagimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallin gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e mjetit me të cilin është kryer vepra penale është marrë konform nenit 62 lidhur me nenin 69 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**PKR.nr.152/16 dt.26.12.2017**

**Procesmbajtësja**  
**Nuriye Rexhëbeqaj**

**Kryetari i trupit gjykues - Gjyqtari**  
**Vesel Ismaili**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

**Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve , nga dita e pranimin të aktgjykimit përmes kësaj gjykate.**